



Datë: 01.12.2025

Numër Protokolli: 7736/2025

A.nr.1741/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2640/2024 të datës 15.09.2025, të Gjykatës Themelore të Prishtinës–Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.520/2024, të datës 12.04.2024, të parashtruar nga ankuesi Xh.B, kundër organit të punësimit Agjencia e Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*Masë Disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 01.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.520/2024, të datës 12.04.2024, të parashtruar nga ankuesi Xh.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Xh.B (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), i punësuar sipas Akt emërimit me numër ZPD 280/2013 të datës 31.12.2013, në pozitën “*Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit*”, në kuadër të Inspektoratit të Pylltarisë në Drejtorinë e Inspektoratit Qendrorë të Pylltarisë, të Agjencisë Pyjore të Kosovës, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 12.04.2024 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli DQIPGJ 139/2024 të datës 15.03.2024, respektivisht masës disiplinore “*vërejtje me shkrim*” të shqiptuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Inspektimit për Pylltari në DQIPGJ.

Tutje, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), më datë 07.06.2024 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.520/2024, me të cilin vendim e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi “*vërejtjen me shkrim*” me numër protokolli DQIPGJ 139/2024 të datës 15.03.2024, të shqiptuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Inspektimit për Pylltari në DQIPGJ.

Ndërsa, ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër A.nr.520/2024 të datës 07.06.2024, të Këshillit, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me datë 15.09.2025, ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.2640/2024, i pranuar me datë 29.09.2025 dhe protokolluar me numër 6425/2025 në Këshill, përmes të cilit ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit (ankuesit), rrjedhimisht ka anuluar vendimin kontestues, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje, tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore **për përfundimin e procedimit administrativ**, sepse:

Kolegji i Këshillit, referuar aktit kontestues, gjegjësisht masës së lehtë disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, të shqiptuar ndaj ankuesit me datë 15.03.2024, dhe duke u bazuar në nenin 57 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përcaktohet se: 1. *Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 1.3. vërejtje me shkrim*;, ndërlidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të nenit 62, ku përcaktohet se: 1. *Masat disiplinore të evidentuara në dosjen individuale parashkruhen pas kalimit të këtyre afateve: 1.2. një (1) vit nga njoftimi i palës për masën e përcaktuar në nën-paragrafin 1.3. të nenit 57 të këtij ligji*;, ka dërguar kërkesë për njoftim tek organi i punësimit i ankuesit, përkatësisht tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, Rural, përmes së cilës ka kërkuar informacion se masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, me numër protokolli DQIPGJ 139/2024 e datës 15.03.2024, a është larguar nga dosja personale e ankuesit.

Ndërsa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, Rural, po me këtë datë (10.10.2025), ka njoftuar Këshillin, se “*vërejtja me shkrim*”, me numër protokolli DQIPGJ 139/2024 e datës 15.03.2024, është larguar nga dosja personale e z. Xh.B.

Andaj, bazuar në atë se ankuesit i është shqiptuar masë disiplinore e përcaktuar nga neni 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i Ligjit Nr.08/L197 për Zyrtarët Publik, e që në kuptim të nenit 62 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të këtij ligji, e njëjta masë është parashkruar, ndërsa sipas Përgjigjes së datës 10.10.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, Rural, rezulton se kjo masë e lehtë disiplinore është larguar nga dosja personale e ankuesit, pretendim i cili ishte parashtruar edhe nga ankuesi në propozimin e tij të ankesës së datës 12.04.2024, Kolegji i Këshillit, vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative

në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.***

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.520/2024, të datës 12.04.2024, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1741/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Xh.B;
- Gjyqtarës Valbona Gjonbalaj - Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.